



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 31975
Datë: 14/12/2016

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në mbledhjen e mbajtur më 17.11.2016, mori këtë:

V E N D I M


- I. Aprovohet raporti i komisionit për ankesa dhe parashtresa, me nr. port: 2/728 i datës 27.10.2016, në përjashtim të pikës 5 të këtij raporti përkatësisht të kandidatit, Veton Haziri.
- II. Pika 5, e raportit të komisionit për ankesa dhe parashtresat të Senatit të UP-së, për kandidatin Veton Haziri, mbetet në fuqi vendimi i komisionit të studimeve dhe vendimi përfundimtar i Senatit të UP-së, ku për grup lëndësh nga Kimia e përgjithshme dhe Kimia inorganike, në FSHMN janë zgjedhur dy asistent që i kanë plotësuar kushte edhe nga komisioni i studimeve edhe nga këshilli i Fakultetit të FSHMN-së.
- III. Pjesë përbërës e këtij vendimi do të jetë raporti i komisionit për ankesa dhe parashtresa, me nr. port: 2/728 i datës 27.10.2016.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

A r s y t i m

Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datë 17.11.2016, pasi e shqyrtoj raportin e komisionit për ankesa dhe parashtresa, me nr. port: 2/728 i datës 27.10.2016, ndaj kandidatëve që kanë ushtruar ankesë kundër vendimit të Senatit të UP-së, ka konstatuar se ankesat janë të pa bazuar, ndërsa për kandidatin Veton Hazir, mbetet vendimi i komisionit të studimeve dhe vendimi përfundimtar i Senatit të UP-së, ku për grup lëndësh nga Kimia e përgjithshme dhe Kimia inorganike, në FSHMN kandidati nuk e ka pasur recesionin të aprovuar nga Këshilli i FSHMN-së, andaj janë zgjedhur dy kandidat tjerë që i kanë plotësuar kushtet. Bazuar në argumentet e sipërshënuara, Senati i UP-së për raportin të ankesave dhe parashtresa, me nr. port: 2/728 vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Zyrtarit ligjor të UP-së.
3. Dekanatit të FSHMN-së;
4. Zyrës për çështje të studentëve.
5. Komisionit për ankesa dhe parashtresa.



Prof. Dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së